Afrim KRASNIQI

FUQITË E MËDHA DHE NDIKIMET NË SHTETFORMIMIN NË EVROPËN JUGLINDORE: RASTI I SHQIPËRISË DHE PRAKTIKAT KRAHASUESE NË GREQI DHE BULLGARI

Abstrakt

Konferenca e Londrës është një ngjarje me rëndësi dhe me ndikime të shumëfishta për shtetin dhe kombin shqiptar. Ajo njohu pavarësinë e Shqipërisë dhe përcaktoi formën e regjimit, si dhe strukturën kryesore të funksionimit të tij. Vendimet e tij mbetën në fuqi për më shumë se një dekadë, deri në formësimin e institucioneve vendore legjitime dhe kalimit në modelin republikan, megjithatë eksperimenti me Princ Wied rezultoi afatshkurtër dhe jo produktiv. Duke e parë Konferencën e Londrës dhe Shqipërinë si pjesë të një procesi dhe në kontestin historik të kohës, është e nevojshme të theksohet se praktika e ndjekur në rastin e Shqipërisë nuk ishte e re dhe se një qasje krahasuese midis modeleve të ndjekura në rajon do të ishte objekt studimi me interes për të analizuar tiparet e përbashkëta dhe dallimet, ndikimin e brendshëm, aktivitetin e institucioneve të krijuara nga Fuqitë e Mëdha të kohës dhe bilancin e tyre për shtetet përkatëse.

Në këtë punim analizohet vendimmarrja e Konferencës së Londrës për Shqipërinë, me modelet e përafërta të aplikuara në Greqi (1832) dhe në Bullgari (1878), roli i Fuqive të Mëdha dhe legjitimiteti i institucioneve të krijuara, si dhe ndikimet e akteve ndërkombëtare në formësimin e shteteve moderne në Evropën Juglindore. Punimi mbështetet kryesisht në dokumentet zyrtare të shteteve respektive, si dhe në studime profesionale mbi objektin e përzgjedhur.

Fjalë kyçe: *Konferenca e Londrës, Fuqitë e Mëdha, Greqia, Bullgaria, Princ Wied.*

Konferenca e Ambasadorëve e njohur si Konferenca e Londrës (1912-1913) është një prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë bashkëkohore të shtetit shqiptar. Rreth 110 vjet më parë ajo zyrtarizoi shpalljen e Shqipërisë si shtet i pavarur dhe subjekt ndërkombëtar, akt politik i ndërmarrë nga vetë shqiptarët në nëntor të 1912 në Kuvendin e Vlorës, por pa njohje ndërkombëtare. Përcaktimi i territorit të shtetit të ri përbën aktin e dytë të vendimmarrjes në Londër, duke lënë jashtë kufijve të shtetit të ri Kosovën dhe pjesë të tjera shqiptare.

Akti i parë përgjithësisht relativizohet dhe bazuar në aktin e dytë Konferenca e Londrës trajtohet në memorien tonë historike dhe publike si një ngjarje me pasoja negative për shtetformimin dhe të drejtat e shqiptarëve. Nga ana tjetër, vendimet e tjera të Londrës për të caktuar një sistem të ri qeverisës në Shqipëri, për emërimin e një Princi perëndimor, për Statutin Organik dhe elementë të tjerë të funksionimit shtetëror përgjithësisht trajtohen si pasojë, dhe në kontekstin e kritikës, si eksperiment dhe devijim nga periudha e mëpasshme shtetërore. Në tërësi Londra trajtohet si proces unik, i shkëputur nga kontesti gjeopolitik dhe i ndërlidhur vetëm me botën shqiptare, duke e zhveshur atë nga konturet, kontesti dhe impakti real që ka pasur.

Analiza e vendimmarrjes, ndikimit dhe pasojave që ato patën në procesin e shtetformimit në Shqipëri mbetet e paplotë nëse nuk zgjerohet në një kontekst më të gjerë të vendosur në retrospektivë dhe paralelisht në kontestin aktual. Për këtë arsye është e nevojshme trajtimi i dy linjave paralele - aplikimi i modelit të njëjtë të Londrës në proceset shtetformuese në Evropën Juglindore, me raste studimi Shqipërinë, Greqinë dhe Bullgarinë, si dhe ngjashmëritë me modele të ngjashme në vendimmarrjet bashkëkohore në të njëjtin rajon, me rast studimi kryesisht Kosova dhe simbolikisht edhe disa praktika të tjera të ngjashme si ai në Bosnjë-Hercegovinë. Cilat ishin tiparet e njëjta dhe dallimet? A kishte ndikim të njëjtë në procesin shtetformues dhe sa funksionale ishin modelet e imponuara nga Fuqitë e kohës? A kemi të bëjmë me vendime penalizuese apo promovuese? A ofruan Fuqitë e Mëdha zgjidhje afatgjatë dhe sa funksional ishte modeli i imponuar nga jashtë? Cilat janë bazat e legjitimitetit dhe cilat mund të ishin mësimet e nxjerra nga analiza në retrospektivë? Cilat janë pikat e takimit dhe veçoritë në kontestin e vendimmarrjeve mbi krijimin e njohjen e shtetit të Kosovës? A ka vend për rivlerësim të Konferencës së Londrës nga koncepti i realpolitikës dhe ndikimeve në shtetformim

në Shqipëri? Trajtimi i këtyre pyetjeve kërkimore mund të bëhet duke analizuar tiparet kryesore të kontekstit politik e vendimmarrës në Londër, modelet e mëparshme dhe ato pasuese, normat kushtetuese dhe format e imponimit/krijimit të legjitimitetit, sukseset dhe dështimet që shoqëruan, si dhe aktorët vendimmarrës dhe trashëgiminë që u krijua atë kohë në praktikat shtetformuese në vende, si: Shqipëria, Greqia, Bullgaria apo në kohët e sotme në Kosovë.

Puna ime kërkimore tenton të japë disa prej përgjigjeve, si dhe të mbështetëse tezën se elementët që e konsiderojnë unike vendimmarrjen e Londrës mbi Shqipërinë në tërësi nuk janë unike, si dhe në kontestin gjeopolitik vendimmarrjet e djeshme e të sotme vijojnë të bazohen kryesisht tek realpolitika, kompromisi dhe zgjidhjet më oportune, të cilat krijojnë distancë me pritshmëritë më të mëdha dhe na dëshmojnë rëndësinë që kanë kultura shtetërore, legjitimiteti i brendshëm dhe aleancat strategjike.

Koncepti i Fuqive dhe Shqipëria londineze

Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, Konferenca e Londrës kritikohet se *“kreu padrejtësinë më të madhe në dëm të kombit shqiptar. Fuqitë pjesëmarrëse nuk i përfillën të drejtat dhe interesat themelore të shtetit të ri shqiptar... në këtë mënyrë nga trungu i atdheut “gërshërët” e rrobaqepësve të mbledhur në Londër” shkëputën krahinat më pjellore dhe që kishin qenë vatra të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare”.*[1] Fjalori është botuar në vitin 1985, kur Shqipëria nuk kishte marrëdhënie shtetërore me Britaninë e Madhe dhe në kushtet e një procesi të gjatë të investimit politik në temat e identitetit dhe patriotizmit. Qasja vlerësuese zyrtare ka mbetur e njëjtë edhe në rrethanat e kundërta, kur Shqipëria e Kosova janë vende aleate me Britaninë e Madhe dhe kur liria akademike mundëson më shumë burime dhe qasje profesionale. Sipas Komisionit Carnegie, Shqipëria u krijua shtet me një popullsi prej 850 000, por caktuan kufijtë e asaj që sot quhet Kosovë, i kaluan Serbisë dhe Malit të Zi.[2] Për shkak të vendimeve të tilla gjejmë cilësimin “Shqipëria londineze” që përkon me kufirin shtetëror të Shqipërisë. Procesi i nisur më 1999

---

[1] *Fjalori Enciklopedik Shqiptar,* Akademia e Shkencave e RSH, Tiranë, 1985, 503.
[2] Carnegie Endowment, *Luftërat e tjera ballkanike, Raport i vitit 1913*, Onufri, Tiranë, 1993.

dhe që përfundoi me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 2008 trajtohet gjerësisht si korrektim i vendimeve të Londrës, një vlerësim i arsyeshëm, por i debatueshëm në aspektin e studimeve.

Në fundin e vitit 1912, ndryshe nga Greqia dhe Bullgaria, shqiptarët nuk kishin një shtet me territor, njohje ndërkombëtare apo autoritete përfaqësuese. Konferenca të mëparshme dhe as Kongresi i Berlinit nuk mori një vendim si për disa vende të tjera në rajon dhe se Lidhja e Prizrenit nuk pati impakt në aspektin e identifikimit shtetëror. Deri më 1912 nuk pati akte të tjera, të ngjashme, si p.sh., shpallja e Pavarësisë. Ata dolën të fundit nga Perandoria Osmane dhe akti i rëndësishëm i Pavarësisë në Vlorë, me gjithë suksesin simbolik nuk arriti dot të krijojë kredencialet e brendshme dhe të jashtme të shtetformimit. Rreth një shekull pas pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, pra si subjekt i barabartë ndërkombëtar, direkt ose indirekt, shqiptarët janë në periudhën më të mirë të fuqisë funksionale në më shumë se dy shtete. Greqia dhe Bullgaria gjithashtu kanë trajektore të ndryshme në aspektin e shtetformimit dhe shtetndërtimit. Sot ato janë vende anëtare në BE, por pikënisja shtetërore daton në disa elementë të ngjashëm me Shqipërinë dhe përfshin eksperimente drejtimi e imponimi nga Fuqitë e Mëdha. Në studimet mbi historinë e Greqisë dhe Bullgarisë gjithashtu gjenden vlerësime kritike për vendimmarrjet fillestare mbi territoret dhe të drejtat, por gjatë shekullit të kaluar të dy vendet ishin më shumë të suksesshme në përputhshmërinë midis territorit dhe synimeve politike.

"E kaluara është një vend i huaj: ata i bëjnë gjërat ndryshe atje" është shprehja e njohur e shkrimtarit L. P. Hartley[3], domethënia e të cilës vlen edhe në kontekstin e analizës retrospektive dhe krahasuese brendashqiptare dhe me zhvillimet e periudhës së shtetformimeve në Ballkan. Përdorimi i koncepteve të historisë krahasuese ka potencialin për të vepruar si një "urë ndërtuese"[4] e mendimit krijues që i zhvendos studiuesit përtej terrenit të njohur të trajnimit të tyre. Kjo tezë provohet në rastin e qasjes krahasimore midis historisë "së kaluar" dhe rivlerësimit nën prizmin e të sotmes. Procesi i shtetformimit në tri shtetet në analizë nisi në kohë të

[3] Duffy Enda, (2004). James Joyce Quarterly, vol. 41, no. 4, 886. JSTOR, http://www.jstor.org/stable/25478124. Accessed 11 Feb. 2024.

[4] Philippa Levine, *Is comparative history possible?* At, History and Theory 53 (October 2014), 331-347, Wesleyan University, 1.

ndryshme, pati trajektore të ndryshme, solli pasoja e ndikime të ndryshme, por baza e tyre parësore mbeti e njëjtë. Fuqitë e Mëdha të kohës iu përgjigjën nevojës për njohjen ose krijimin e shteteve të reja, përmes vendimmarrjeve të jashtme të bazuara në kompromise gjeopolitike dhe marrëveshje midis konceptit të imponimit nga jashtë dhe konceptit të legjitimitetit nga brenda.

Modeli i Konferencës së Londrës dhe i akteve të ngjashme bazohet në ekzistencën e Fuqive të Mëdha, me autoritet dhe legjitimitet vendimmarrës mbi shtete të reja dhe kryesisht të vogla. Konferenca e Londrës 1912-1913 ishte imituese e Protokollit të Londrës (1830), i cili zyrtarizoi pavarësinë e Greqisë. Kongresi i Berlinit trajtoi rastin bullgar dhe disa shtete të tjera rajonale, dhe se pakte të tjera midis vetë Fuqive të Mëdha apo përballë Perandorisë Osmane patën impakt të rëndësishëm në konfigurimin e shteteve dhe territoreve të reja të pavarura në të gjithë hapësirën e sotme të Europës Juglindore.

Në tri rastet e atëhershme në shqyrtim (Shqipëria, Greqia dhe Bullgaria) dhe në rastet e sotme referuese (Kosova, Afganistani, Iraku, Timori Lindor apo Bosnja) instrumenti vendimmarrës i “Fuqive të Mëdha” mbetet i pandryshuar. Ndryshon forma dhe përbërja, fuqia e secilit aktor përbërës dhe ekzistenca ose jo e Perandorive, por thelbi mbetet i njëjtë. “Fuqitë e Mëdha”, ndryshe nga Këshilli i Sigurimit në OKB, Bashkimi Evropian dhe NATO sot, nuk përfaqësonin një strukturë të zgjedhur dhe me mandat universal. Potenciali i tyre politik, ekonomik dhe ushtarak i bënte ato si fuqi vendimmarrëse dhe autoritete të imponueshme e negociatore të vetme në mesin e pretendentëve për krijimin e shteteve të reja.

Gjatë shekullit XIX kjo u bë në rivalitet ose partneritet me Perandorinë Osmane, fuqia “tjetër” përballë. Në rastin e Shqipërisë dhe Bullgarisë Fuqitë e Mëdha vendimmarrëse ishin gjashtë: Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria, Rusia dhe Italia; kurse në rastin e krijimit të shtetit modern grek Fuqitë e Mëdha ishin tri: Britania, Franca, Rusia. Në tri rastet vendimet u morën pa konsultim dhe përfshirje të faktorëve vendorë, përkatësisht shqiptarëve, grekëve apo bullgarëve, por në dy raste vendimet ishin në konsultim dhe miratim paraprak nga Perandoria Osmane. Baza e gjerë e mbështetjes - Fuqitë e Mëdha, Perandoria Osmane, shtetet fqinje etj., u dha fillimisht garanci të forta shteteve të reja dhe u shënuan raste kur i mbrojti ato nga kërcënime të ndryshme rajonale. Për shembull,

ndërhyrja e një ose disa Fuqive të Mëdha dhe jo vendimmarrja unilaterale e autoriteteve vendore largoi trupat greke nga Shqipëria Jugore më 1914, trupat malazeze nga Shkodra, trupat e vendeve të tjera nga territori i shtetit të ri gjatë Luftës së Parë Botërore etj. Praktika të njëjta gjenden edhe në rastin e Greqisë dhe Bullgarisë, por janë provuar edhe në Bosnjë apo Kosovë gjatë dekadave të fundit, duke provuar tezën se mekanizmi kujdestar mbetet i njëjtë pavarësisht zhvendosjes në kohë dhe evoluimit të së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare.

Forma dhe baza e vendimmarrjes nga jashtë

Referuar praktikave në tri vendet rezulton se Fuqitë e Mëdha shfaqen njëherësh si krijuese e shteteve, por edhe e kornizës kushtetuese të qeverisjes së tyre. Me traktatet e dy konferencave të Londrës, Greqia dhe Shqipëria u shpallën monarki kushtetuese dhe të trashëgueshme pa lidhje suzereniteti me Turqinë[5], me traktatin e Berlinit Bullgaria fitoi vetëm *"autonomi substanciale"* nga Perandoria, duke mbetur *de facto* vend në varësi prej saj deri më 1908. Duke qenë produkt ndërkombëtar, pa praninë e vet faktorëve vendorë, vendimet e Fuqive të Mëdha për dhënien e Pavarësisë dhe vetë koncepti i pavarësisë ishin relative. Në aspektin shtetëror dhe të legjitimitetit situata ishte edhe më paradoksale: shtetet e reja ishin të pavarura, por forma qeverisëse, kushtetutat dhe princat drejtues, qeveritë dhe autoritetet kryesore, politika e mbrojtjes, ajo financiare dhe jashtme ishin paracaktuar prej tyre.

Shtetet e reja ishin të brishta në burimet e veta të domosdoshme për mbijetesë, institucionalizim dhe më pas për shtetndërtim të suksesshëm. Greqia pati nevojë një periudhë të gjatë kujdestarie nga jashtë, përfshirë asistencë financiare dhe ekonomike, për të krijuar bazat e shtetit të ri. Princ Otto erdhi në Greqi me 3 500 ushtarë bavarezë si mbështetje dhe përgjegjëse për sigurinë e tij, ushtarakë të lartë bavarezë u caktuan për të reformuar dhe trajtuar ushtrinë e re greke. Shtetit grek iu dha një kredi lehtësuese prej 60 milionë franga, të mjaftueshme për menaxhimin fillestar të qeverisjes

[5] Sipas nenit 1, të vendimit të Londrës (29.07.1913) "Shqipëria formohet si një principatë autonome, sovrane dhe e trashëgueshme sipas rendit të paralindjes, nën garancitë e të gjashtë Fuqive. Princi do të caktohet nga të gjashtë Fuqitë".

dhe projekteve ekonomike[6]. Ai u asistua nga regjenca e përbërë nga tre zyrtarë të lartë gjermanë[7], kurse në Bullgari i njëjti model u aplikua por me zyrtarë dhe gjeneralë të lartë rusë.

Në rastin e Shqipërisë u përcaktua se "kontrolli i administratës civile dhe i financave i besohet një komisioni ndërkombëtar të përbërë nga delegatët e gjashtë Fuqive dhe nga një delegat i Shqipërisë" (neni 4), "ky komision do të ngarkohet me hartimin e një projekti të hollësishëm për organizimin e të gjitha degëve të administratës së Shqipërisë" (neni 6), "qetësia dhe rendi publik do të sigurohen nga organizimi ndërkombëtar i xhandarmërisë. Ky organizim do t'u besohet oficerëve të huaj, që do të kenë komandën eprore dhe efektive të xhandarmërisë" (neni 8), "këta oficerë do të zgjidhen në radhët e ushtrisë së Suedisë" (neni 9), si dhe "rrogat e këtyre oficerëve mund të sigurohen nga burimet e vendit me garancinë e Fuqive" (neni 11).[8]

Pra, të gjitha strukturat e rëndësishme në fushën e sigurisë dhe administrimit, përfshirë asistenca fillestare financiare edhe në rastin e Shqipërisë u përcaktua ose u mbulua nga Fuqitë e Mëdha përbërëse të Konferencës së Londrës. Bullgaria gjithashtu pati përvojë të ngjashme jo vetëm financiare por edhe administrimi, sidomos nga dy gjeneralët rusë Sobolev dhe Kaulbars, të cilët përfaqësonin zyrtarisht Carin rus dhe ushtruan kompetenca të gjera në oborrin e Alexandrit. Modele të njëjta të ngjashme, por me emërtime dhe bazë ligjore bashkëkohore gjejmë edhe në Bosnjën e pasluftës, Kosovën e pasluftës dhe vendet e tjera ku ndërhyri bashkësia ndërkombëtare. Midis 1999 dhe 2008 Kosova kaloi testin e shtetndërtimit përmes një roli kujdestar të strukturës ndërkombëtare në dy nivele, në administrimin civil dhe ushtarak. Në Bosnjë prania ndërkombëtare krijoi bazat e mbijetesës së eksperimentit ndëretnik, në Maqedoninë e Veriut pas konfliktit të

---

[6] George Tridimas, (2017). *When the Greeks Loved the Germans: The Political Economy of King's Otto Reign, in Tafterjournal*, 95, 2017. (www.tafterjournal.it/2017/07/15/ëhen-the-greeks-loved-the-germans-the-political-economy-of-kings-otto-reign/

[7] Konti Joseph von Armansperg kishte përgjegjësinë për ushtrimin e kontrollit ekzekutiv, profesori i së drejtës Ludwig von Maurer u angazhua për modernizimin e bazës ligjore të shtetit, si dhe gjenerali Karl Wilhelm von Heideck për të administruar ushtrinë.

[8] Afrim Krasniqi, *Sistemet politike në Shqipëri 1992-2009*, UFO Press, Tiranë, 2009, 38, shih: Vendimet e Konferencës së Londrës, 1913.

viteve 2000 mandati ndërkombëtar siguroi negociata dhe proces ndërveprimi midis dy etnive kryesore.

Në tri shtetet në fokus fuqitë e brendshme pretenduese për drejtim ishin në rivalitet të ashpër politik dhe apriori të refuzuar nga pala rivale. Në Greqi përpara zgjedhjes së Otto Greqia ishte në gjendje kaotike, në një luftë civile që pasoi vrasjen e figurës më të rëndësishme politike I. Capodistrias. Zgjedhja e Princit shihej si shans për rikthimin e stabilitetit dhe i dha mundësinë Greqisë të fitonte status të barabartë ndërkombëtar me shtetet e tjera evropiane. Zhgënjimi nga gjendja dhe pritshmëritë e mëdha ndikuan në pritjen pozitive popullore që grekët i bënë emërimit të princit të ri. Në Bullgari gjithashtu rivaliteti midis forcave të ndryshme vendore ishte i madh dhe vendi ishte në kërkim të një qeverisjeje të qëndrueshme.

Vendimi për monarkinë dhe caktimin e Princit të ri gjithashtu u prit me entuziazëm nga qytetarët dhe elitat vendore. Në Shqipëri situata ishte e njëjtë, pavarësisht shkëputjes në kohë. Dy qeveritë paralele vendore, ajo e Vlorës e drejtuar nga Ismail Qemali dhe ajo e Tiranës e drejtuar nga Esat Toptani ishin në rivalitet dhe pa bazë të fortë legjitimiteti, pa njohje ndërkombëtare dhe me tregues kritikë në aftësinë për qeverisjen reale të vendit.

Rivaliteti lokal kishte impakt destabiliteti të brendshëm, pafuqinë për të ushtruar qeverisje efektive, faktor frenues edhe për vendimmarrje strategjike lidhur me formën e qeverisjes, ndërtimin e institucioneve përfaqësuese dhe hedhjen e themeleve të shtetformimit dhe në këtë formë, kufizonte mundësitë dhe mjetet për politikë të jashtme dhe njohje ndërkombëtare. Nevoja për stabilitet, qeverisje efektive qendrore, bashkimin e vendit dhe fokusimin tek problemet madhore i shtynë vendet të jenë optimiste dhe të pranonin verdiktin e ofruar nga Fuqitë e Mëdha. E njëjta kurbë mund të faktohet edhe në Kosovën e pas 1999 apo situatën në Bosnjë pas 1995. Faza e parë pasuese u shoqërua nga entuziazmi dhe besimi, por gjatë ushtrimit të qeverisjes secili prej vendeve u ndesh në sfida të mëdha, të cilat u përmbushën vetëm pjesërisht.

Roli në qeverisjen lokale i Fuqive të Mëdha

Ekzistojnë teori politike sipas të cilave lloji i regjimeve të instaluara në Greqi, Bullgari, Shqipëri, Rumani etj., reflektojnë parashikimet e teorisë përzgjedhëse të studiuesit De Mesquita (2003)[9], sipas të cilit, nëse një fuqi fitimtare imponon një qeveri kujdestare ajo preferon të ndryshojë institucionet politike në atë mënyrë që politika e jashtme e saj t'i shërbejë interesave politike të fitimtarit. Sipas saj, fuqitë fituese (në këtë rast Fuqitë e Mëdha) nuk janë të interesuara për qeveri të forta dhe funksionale në shtetet e reja, por qeveri të brishta, pa potencial kundërshtues dhe në nevojë për kujdestari. Në tërësi në tri rastet qeveritë e zgjedhura ishin të tilla, duke pasur parasysh edhe dobësinë e tyre financiare, kufizimet institucionale dhe mungesën e aftësisë ushtarake për të sfiduar *status quo*-në diplomatike.

Një tjetër teori thekson se interesi themelor i një force të jashtme pushtuese ose dominuese është imponimi i vullnetit të vet tek një komunitet/grup lokal dhe sundimi kryesisht me forma autokratike.[10] Teoria bën dallimin midis banditizmit shëtitës që synon maksimalizimin e fitimit brenda një kohe të shkurtër dhe me forma ekstreme represive dhe banditizmit të qëndrueshëm që krijon një mjedis më jetëgjatë në emër të së mirës publike, në formën e mbrojtjes nga armiqtë, në emër të ligjit dhe të zhvillimit infrastrukturor duke maksimizuar prodhimin dhe për rrjedhojë taksat e të ardhurat për të. Disa elementë të kësaj teorie provohen edhe në rastet konkrete, sidomos në interesat kontradiktore të fuqive emërtuese gjatë ushtrimit të mandatit nga ana e princave. Shteti i centralizuar, i evoluar nga absolutizmi francez, u bë shembulli kryesor për të imituar të gjitha shtetet kombëtare në Evropë gjatë shekullit XIX, model që u reflektua edhe në shtetet e reja në EJL.[11]

Një proces shtetformimi krijon ndërvarësi midis autoritetit të deleguar dhe vetë fuqisë vendimmarrëse; në rastin konkret të studimit, midis Princit dhe Fuqive të Mëdha që e kanë emëruar atë dhe kornizën kushtetuese të veprimit të tij. Referuar praktikës së tri vendeve aftësia

[9] Bueno de Mesquita, B., Siverson, R.M.Smith, A. & Morrow, D.J. (2003). The Logic of Political Survival. Cambridge, Mass: MIT Press.
[10] Olson, M. (1993), "Dictatorship, democracy, and development," *American Political Science Review* 87: 567-576.
[11] Hans Kohn, "Nationalism", in David Sills, ed., *Encyclopedia of the Social Sciences*, London 1972, Vol. II, 67.

e vetë shteteve për të krijuar struktura të qëndrueshme dhe politikë të jashtme dhe të brendshme funksionale mbetej e kushtëzuar. Bilanci politik dëshmon se gjatë periudhave kur shtetet e reja dhe vetë Fuqitë e Mëdha funksionuan në mënyrë harmonike, impakti në vendet përkatëse ishte pozitiv në shumicën e aspekteve. Mosmarrëveshjet dhe grindjet midis dy palëve dhe më pas midis vetë shtetit dhe një ose disa Fuqive të Mëdha, sollën pasoja negative gjithnjë e më të mëdha. Në rastin e Greqisë, Otto pati mbështetje kryesore britanike, por kur vetë Britania hyri në konflikt në Kretë dhe me Perandorinë Osmane, regjimi hyri në krizë pa kthim. Në Bullgari aleati kryesor ishte Rusia, por kur divergjencat lindën në 1883 ndodhi i njëjti fenomen. Në Shqipëri situata ishte më komplekse, pasi duke mos pasur një vend kujdestar, por dy vende në rivalitet lokal dhe gjeopolitik, Italinë e Austrinë, hyrja e tyre në luftë ndaj njëri-tjetrit pas, solli menjëherë dështimin e investimit në Shqipëri dhe fundin e principatës.

Të njëjtat vlerësime gjenden edhe në kohët më bashkëkohore të konflikteve dhe situatës së shtetformimeve të reja, përfshirë edhe në Bosnjë apo në Kosovë. Reagimi në unison i fuqive të kohës solli ndërhyrjen e NATO në Kosovë për të parandaluar përmasat tragjike të humbjeve civile, kurse në Bosnjë, mungesa e kësaj dakordësie u shoqërua me një numër shumë të lartë viktimash civile. Konsensusi politik solli marrëveshje me rëndësi për paqen, si Marrëveshja e Dejtonit apo e Kumanovës, kurse mungesa e dakordësisë apo përdorimi i vetove në interes të qasjeve gjeopolitike vazhdimisht shkaktoi pasoja dhe viktima në të dy vendet. Të njëjtat mësime gjenden të ilustruara edhe në Irak, apo zona të tjera të konflikteve bashkëkohore.

Në rastin e Princ Otto, Wied dhe Alexander, fuqitë emërtuese manifestuan momente publike refuzimi, konflikti dhe deri edhe denigrimi, me pasoja jo vetëm personale për ta, por edhe për legjitimitetin e qeverisjes dhe qëndrueshmërinë e saj. Në dy prej rasteve kreditë financiare të premtuara nuk u lëvruan të plota, presioni për pagesën e kredive u bë në forma imponuese për masa drastike ekonomike, kufizimet në fuqitë ushtarake u mbajtën të kontrolluara nga jashtë dhe skena sabotimi, si p.sh., detyrimi i Princ Wied që në përballjen e parë me rebelët të strehohet në anijen italiane, apo refuzimi i mbrojtjes ushtarake edhe për jetën e tyre personale, apo detyrimi i Alexander për të mos dënuar krerët rebelues ushtarakë apo për Princ Wied për të mos dënuar drejtuesin kryesor politik të

rebelimit, ishin tregues dobësie për vetë eksperimentin dhe procesin e shtetndërtimeve të reja. Së fundi, fakti se vetë Fuqitë e Mëdha nuk respektuan në vijim kurorën mbretërore të përzgjedhur prej tyre Wied nuk u lejua të rikthehet më në Shqipëri, Otto gjithashtu mbeti i izoluar, kurse Alexander u detyrua të abdikojë dhe në tërësi pas Luftës së Parë Botërore rihapën negociatat midis tyre për kufijtë e ri të shteteve të krijuara prej tyre, është gjithashtu tregues kritik për rolin e tyre në proceset historike të shtetformimit në Evropën Juglindore. Në kushtet aktuale e njëjta gjë mund të thuhet për mungesën e vendimit për njohjen e Kosovës nga pesë shtete anëtare në BE, apo përdorimi periodik i vetos nga ndonjë fuqi në OKB në pengimin e progresit dhe njohjes së gjerë ndërkombëtare të shtetit të ri të Kosovës.

Në analizën krahasuese midis vendeve del në pah rëndësia e pozitës gjeopolitike dhe balancave të pushtetit në kancelaritë kryesore europiane. Gjeopolitika dhe aleancat historike ndikuan shumë në proceset e vendimmarrjes, natyrën e tyre dhe rezultatet. Modeli i Londrës, Berlinit apo konferencave të tjera të njëjta edhe në kohët e sotme, krahas mungesës së përputhshmërisë midis vendimeve dhe pritshmërive vendore, tregojnë edhe se cilësia e tyre ndërvaret nga pozita e shtetit kujdestar brenda vetë Fuqive të Mëdha.

Mekanizmat paqësorë të Fuqive të Mëdha që funksionuan në Londër dështuan një vit më pas kur shpërtheu Lufta e Parë Botërore. [12] Disa nga vendimet në Londër u morën mbi bazën e diplomacisë dhe mirëbesimit, por disa të tjera u imponuan nga forca ushtarake derisa edhe vetë fuqitë negociuese u përfshinë në konflikt përballë njëra-tjetrës. Në Luftën e Parë Botërore Shqipëria humbi Austro-Hungarinë, shtetin më mbështetës, dhe me paktin e dytë të Londrës më 1915, i dha rol Italisë, shtet i cili më 1939 u bë vend agresor e pushtues. Greqia mori kujdestarinë britanike, por gjatë e pas Luftës së Dytë Botërore kjo aleancë rezultoi e qëndrueshme dhe një prej faktorëve përcaktues në orientimin e vendit në kuadër të Perdes së Hekurt. Bullgaria u mbështet në mbështetjen ruse, e cila ishte faktor vendimtar edhe në fatet e këtij vendi pas Luftës së Dytë Botërore.

---

[12] *Oliver* Jens Schmitt, *Ballkani në shekullin XX. Një histori post-imperiale*, Artini, Kosovë, 2021, 52.

Eksperimentet "gjermane": të përbashkëta dhe dallime

Në tri rastet Fuqitë e Mëdha krijuan shtete, nuk shpërbënë shtete. Kritika se procesi i krijimit nuk mori në konsideratë pritshmëritë dhe realitetet nacionale janë të drejta, por niveli i kritikës ndryshon në varësi nga vendet. Në tri rastet autoritetet formale dhe informale lokale nuk ishin pjesë e vendimmarrjes, nuk kishin legjitimitet përfaqësues dhe as njohje ndërkombëtare, dhe si të tilla, nuk mund të ndikonin në negociatat mbi territoret dhe as statutin. Fuqitë vendimmarrëse u bazuan kryesisht tek nevoja për shtete kombëtare dhe reflektimin e realpolitikës, negociatat midis palëve me interesa të kundërta dhe gjetjen e balancave gjeopolitike fillimisht midis vetë fuqive dhe më pas midis shteteve të reja dhe fqinjëve të tyre.

Në rastin shqiptar ndarja e elementit kombëtar ishte drastike në raport me sipërfaqen e shtetit të ri. Përcaktimi i territoreve rezultoi proces më me impakt sesa përcaktimi i kurorës mbretërore. Shqipërisë iu deshën rreth një dekadë për të zyrtarizuar kufirin "londinez", por duke e njohur *de facto* vendimet penalizuese të Londrës. Situata e Luftës së Dytë Botërore përbën përjashtim dhe merr vlerë në kontekstin e raporteve të reja midis Fuqive të Mëdha në luftë, por pas luftës kufijtë mbetën të njëjtë me ata të përcaktuar në Londër. Në anën tjetër, Shqipëria nuk pati veprime ushtarake të brendshme imponuese ndaj ecurisë së bisedimeve në Londër, përkundrazi, Londra dhe jo aktorët vendorë arritën të largonin nga vendi trupat pushtuese greke dhe malazeze, një tregues edhe i brishtësisë dhe vështirësive në investimin e Fuqive të Mëdha në një shtet ende pa kapacitetet mbrojtëse apo ndërvepruese.

Në Greqi e Bullgari situata ishte e njëjtë dhe mori më shumë kohë sesa në rastin e Shqipërisë në përcaktimin e kufijve të sotëm. Sipas marrëveshjes së re, Bullgaria ndahej përgjatë maleve të Ballkanit në dy pjesë: në atë veriore që u shpall principatë autonome, duke i paguar haraç Turqisë; dhe ajo jugore (Rumelia Lindore) - mbeti nën sundimin turk në kushtet e autonomisë administrative. Maqedonia, e cila me Traktatin e Shën Stefanit bënte pjesë në Bullgari, iu dha edhe Turqisë. Në rastin e Greqisë gjithashtu, më 1832, territori ishte i cunguar, duke lënë jashtë hapësira të shumta, përfshirë edhe qytete me rëndësi si Kreta. Në mbretërinë greke të Ottos jetonin më pak qytetarë grekë se numri i atyre që jetonin në territore nën

Perandorinë Osmane, fakt që nxiti vazhdimisht pretendimet greke për politika nacionaliste që synonin bashkimin territorial të zonave të banuara nga grekët. Greqia i zgjidhi problemet themelore të kufijve në vitin 1947, pra më shumë se një shekull më vonë dhe në kushte të reja gjeopolitike e shtetërore. Bullgaria humbi gjithashtu territore, dhe krijimi i territorit unik vijon të jetë edhe sot pjesë e retorikës nacionaliste. Dy vendet negociuan përmes veprimeve ushtarake në terren, pra duke ndërthurur diplomacinë me forcën, praktikë që ndoqën edhe disa vende të tjera rajonale, përfshirë Mali i Zi, Serbia dhe Rumania. Për pasojë, territoret e krijuara prej Fuqive të Mëdha, vetëm në rastin e Shqipërisë përputhet me hartën e sotme shtetërore, kurse në Greqi e Bullgari territoret vijuan të zgjeroheshin.

Fokusimi tek korrektimi i modelit të Londrës në çështjen e kufijve në tërësi mbeti politikë e qëndrueshme tek secili vend. Secili vend - Greqia pas konfliktit midis Perandorisë Osmane dhe Egjiptit, Bullgaria pas konfliktit me serbët dhe osmanët dhe vetëm pjesërisht Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore - dështoi në korrektimin e territoreve për shkak se interesat e fuqive vendimmarrëse të kohës ishin të kundërta me ato të tyre. Dështimet u pasuan me dobësimin e ndikimit të elitës politike dhe kurorave mbretërore, si dhe me respektimin gjithnjë e më shumë nga secili vend i territoreve të sanksionuara në konferencat e mëdha nga Londra, në Kostandinopojë, Berlini dhe deri në Jaltë.

Konferenca e Londrës më 1832 dhe protokollet pasuese shpallën krijimin e shtetit të Greqisë me Princ Otto në krye, Kongresi i Berlinit krijoi Bullgarinë me Princ Alexander në krye, si dhe Konferenca e Londrës më 1913 krijoi shtetin shqiptar me Princ Wied në krye. Pavarësisht dallimeve në kohë, Fuqitë e Mëdha imponuan të njëjtin model qeverisës: krijimi i Principatave, emërimi i një Princi europian në krye, rol kujdestar nga përfaqësia diplomatike, si dhe raporte ndërvarësie nga vetë Fuqitë. Në Greqi Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Londrës më 1832 emëruan 17-vjeçarin Princ Otto nga Bavaria (Gjermani), si mbret të Greqisë dhe shpallen Mbretërin e Greqisë. Princ Otto qeverisi Greqinë për 30 vjet deri në dëbimin e tij më 1862, duke ia lënë vendin princit suedez George I (Xhorxh I), i cili qeverisi Greqinë midis 1863-1913. Në Bullgari midis 1879-1886 drejtoi Princ Aleksander, (Alexander of Battenberg) dhe pas rrëzimit të tij, froni i kaloi austriakut Princ Ferdinandit, i cili e drejtoi deri në fundin e Luftës së Parë Botërore. Në tri rastet procesi i emërimit të

princit/mbretit kaloi përmes negociatash dhe me kandidatë që refuzuan ofertën. Vendosja e princërve gjermanë në krye të tri shteteve, por më tej edhe në krye të Rumanisë, reflekton rrethana specifike në balancën midis fuqive të përfshira në bisedime, ku Gjermania përbënte një prej fuqive më neutrale e të fuqishme, si dhe reflektonte pjesshëm edhe interesin e vet princave dhe familjeve mbretërore.

Princ Otto në Greqi, Princ Alexander në Bullgari dhe Princ Wied në Shqipëri ishin zgjedhje kompromisi midis Fuqive, pa njohje të mëparshme me vendet që drejtuan. Ata morën kurorat dhe qeverisën në kohë të ndryshme, por në thelb, patën fate personale të njëjta: të tre ishin ushtarakë karriere, të tre kishin të përbashkët edhe mungesën e njohurive të thelluara dhe të përvojës drejtuese në nivele të larta qeverisëse, moshën e re dhe kufizimet në aftësitë diplomatike, të tre shijuan suksesin dhe dështimet, dhe të tre u rrëzuan nga trazira ose grushte shteti duke iu ndërprerë vijueshmëria e kurorës së tyre familjare. Modelet pasuese, Xhorxhi I në Greqi dhe Princi Ferdinand në Bullgari patën sukses më të madh, por me Luftën e Parë Botërore kapitulli i tyre u mbyll.

Në Shqipëri vendi i Wied mbeti i lirë gjatë Luftës së Parë Botërore, u zëvendësua përkohësisht nga Këshilli i Naltë i Shtetit në vitet ‘20, dhe më pas nga ndryshimi i formës së qeverisjes, kalimi në republikë më 1925. Otto në Greqi dhe Wied në Shqipëri nuk abdikuan asnjëherë nga posti dhe vijuan të respektonin kurorat përkatëse, ndërsa Alexander pranoi abdikimin dhe më pas iu bashkua si ushtarak, njësive ushtarake austriake.[13] Nga ana tjetër, Mbreti George I në Greqi dhe Ferdinand I në Bullgari patën përvoja të ndryshme dhe pjesërisht mësuan nga eksperimentet e mëparshme, megjithatë edhe fati i tyre u përcaktua më shumë nga fatet e Luftës së Parë Botërore dhe zhvillimet gjeopolitike sesa nga vendimet dhe aftësia e tyre personale.

Lidhur me legjitimitetin vetëm rasti shqiptar përbën përjashtim: të dy princat e tjerë, Otto dhe Alexander morën mbështetjen e autoriteteve vendore që gëzonin legjitimitet përfaqësues. Zgjedhja e Princ Otto u ratifikua nga Asambleja e Pestë Kombëtare e Greqisë në 1832, kurse në rastin e Bullgarisë Princ Alexander u votua formalisht nga Asambleja Kombëtare e Bullgarisë

---

[13] John Belchem and Richard Price, eds. *A Dictionary of 19th-Century World History*, 1994, 66.

më 1979. Tek rasti i Princ Wied nuk kishte parlament të tillë dhe vetëm me Statutin Organik parashikohej krijimi i një Asambleje Kombëtare. Wied nuk hasi në rezistencë brenda vendit dhe krerët vendorë e mbështetën ardhjen e tij, ndonëse për një periudhë të shkurtër kohore.

Efektet dhe trashëgimia e drejtimit evropian në tri shtetet

Bilanci i qeverisjes ndryshon nga vendi në vend, duke reflektuar edhe veçoritë kohore, jetëgjatësinë e qeverisjes dhe impaktin e vendimeve për vendet përkatëse. Princ Otto ka një trashëgimi shumë më pozitive sesa dy modelet e tjera. Nën drejtimin e tij u bënë ndryshime të rëndësishme në strukturën ligjore të vendit, praktika bavareze penale dhe civile u jetësuan edhe për Greqinë, duke përshtatur elementë të veçantë me të drejtën zakonore, ndërsa në fushën e tregtisë mbeti në fuqi Kodi i Napoleonit, i përhapur gjerësisht në të gjithë Mesdheun. Oborri mbretëror bavarez u fokusua me prioritet në zhvillimin e sistemit arsimor, duke jetësuar tri nivelet e studimit dhe hequr monopolin fillestar të shkollimit nga Kisha. Ekipe ekspertësh, përfshirë urbanistë dhe arkitektë u sollën nga Gjermania, duke projektuar dhe ngritur pjesë të rëndësishme të kryeqytetit të ri, Athinës.

Zhvillimi ekonomik ishte i ndjeshëm dhe standardet e jetesës gjithashtu. Greqia fitoi kredenciale dhe territore, duke u bërë një ndër shtetet më me ndikim në rajon. Nga ana tjetër, Princi Alexander qëndroi në pushtet për një periudhë të shkurtër, 1879-1886 dhe qeverisi në kushte më specifike. I influencuar sidomos nga Rusia dhe presionet e brendshme, Alexandri fillimisht miratoi një Kushtetutë liberale (1879) pastaj e shpërndau parlamentin (1880) dhe pezulloi Kushtetutën (1881). Reagimi kritik tek elitat vendore dhe qytetarët, kryesisht ndaj të dërguarve rusë, detyroi Princin të rivendoste Kushtetutën vetëm dy vjet më vonë, më 1883, por 3 vjet më vonë u detyrua të abdikojë. Në Shqipëri Wied ishte edhe më i pafat dhe me një bilanc shumë më modest. Wied u ndesh me sfidat për të krijuar qeverisje dhe jetësuar konceptin e sovranitetit shtetëror (largimin e ushtrive të huaja, njësimin e pushtetit qendror), duke mos pasur mundësi të fokusohej në problematika konkrete të qeverisjes. Miratimi i Statutit Organik të Shqipërisë u bë në prill 1914, një muaj pas ardhjes së Wied në Shqipëri dhe vetëm pesë muaj përpara se ai të

detyrohej të braktiste vendin. Për pasojë, shumica absolute e normave të këtij Statuti nuk arritën të jetësoheshin në praktikë.

Me rënien e qeverive lokale ranë edhe institucionet vendore të krijuara nga aktorët vendorë. Në Bullgari dhe Greqi u shpërndanë asambletë dhe strukturat vendimmarrëse, në Shqipëri u shpërbë Pleqësia dhe strukturat e dala nga Kuvendi i Vlorës. Në tri vendet procesi u shoqërua edhe me ndryshimin e elitave politike vendore - duke larguar nga drejtimi kryesor figurat më të rëndësishme të lëvizjeve për pavarësi, si dhe duke çarmatosur dhe organizuar trupat ushtarake dhe të rezistencës, pavarësisht se në vende si Bullgaria e Greqia ato kishin kontribute të mëdha dhe mbështetje publike.

Efekti më i madh i eksperimenteve të imponuara nga Fuqitë e Mëdha lidhen me investimin në kulturën politike dhe orientimin perëndimor të shteteve të reja. Greqia përfitoi më shumë se secili vend tjetër nga investimi Perëndimor. Nga vendimet e Konferencës së Londrës deri më 1912 kur Shqipëria shpalli pavarësinë, Greqia kishte eksperimentuar me dy mbretër, rreth 25 procese zgjedhore parlamentare e vendore, si dhe me rreth 80 qeveri e dy kushtetuta.

Në këtë mënyrë ajo investoi shumë në formimin e kulturës demokratike të qeverisjes, e cila në perspektivë u dëshmua si model pozitiv dhe më i suksesshmi në vendet e Evropës Juglindore. Në Bullgari gjithashtu impakti ishte pozitiv, por i limituar kryesisht për shkak të dominimit të ndikimit rus dhe qenies më në periferi të Europës, një zonë më me shumë konflikte rajonale, kurse në Shqipëri eksperimenti ishte jetëshkurtër dhe me rezultate vetëm simbolike. Cili do të kishte qenë rezultati nëse eksperimenti “gjerman” do të ishte aplikuar edhe në Shqipëri prej 1832? Cili do të kishte qenë fati i mëtejshëm i Shqipërisë në konceptin shtetëror, territorial, kulturor dhe demokratik? Shqipëria mbeti e vonuar në të gjithë procesin historik: autonomia, pavarësia, njohja ndërkombëtare, krijimi i shtetit, kushtetuta e zbatuar, koncepti liberal i demokracisë, pluralizmi apo modernizimi-duke “iu bashkuar” të tjerëve vetëm në eksperimentimin e sistemit njëpartiak komunist, por edhe këtu, në formën e tij më të skajshme, nga stalinizmi fanatik tek izolimi i plotë ndaj Perëndimit e Lindjes. Pjesë të bilancit pozitiv të importimit të modelit perëndimor përmes Princ Otto, ishin sidomos investimet e mëdha në konceptin e shtetit, të institucioneve, të arsimimit, infrastrukturës, lidhjeve me botën dhe njësimit të organizimit strukturor shtetëror - elementë që në

vende si Bullgaria erdhën me shumë vonesë, kurse në Shqipëri u aplikuan pjesërisht rreth një shekull më vonë.

Me të drejtë Fukuyama thotë se nga trajtimi historik, normat kulturore dhe historitë specifike të vendeve janë shumë më të rëndësishme sesa institucionet formale dhe efikasiteti i tyre për t'i bërë shtetet efektive. Suksesi i shtetndërtimit në raste të tilla varet nga kërkesa e krijuar në vend.[14] A kishte Shqipëria kërkesë e presion nga poshtë për një model më efektiv dhe më të hapur qeverisës? Me përjashtim të Lidhjes së Prizrenit dhe disa akteve të tjera, si Kongresi i Manastirit, nuk ka të dhëna që provojnë ekzistencën e një vizioni, vullneti dhe presioni. Në dallim nga modeli ynë, në Greqi që më 1822 u miratua akti i parë kushtetues, dhe më 1832 ishte Asambleja e pestë Kombëtare që miratoi kushtetutën e re, siç thuhet në studime, "një bashkim i frymës republikane amerikane të Kushtetutës me praktikat monarkiste të trashëgimit të pushtetit nga kryetari i shtetit". [15]

Kushtetuta e re e vitit 1844 u bazua kryesisht në modelin e kushtetutave franceze dhe belge të vitit 1830, duke garantuar liritë individuale dhe politike.[16] Pushteti legjislativ ushtrohej nga mbreti, parlamenti përbëhej nga dy dhoma (parlament i zgjedhur dhe Senat i emëruar nga Mbreti) - një model që në Shqipëri do të aplikohej në formën republikane të qeverisjes në vitet 1925-1928. Funksionet klasike të mbretit në emërimin e shkarkimin e ministrave dhe zyrtarëve të lartë, gjyqtarëve dhe e drejta e shpërndarjes së parlamentit u konfirmuan gjithashtu. E drejta e votës bazohej në votimin e meshkujve mbi 25 vjeç me kusht paraprak, zotërimi i një toke dhe i një profesioni, një praktikë që grekët e liberalizuan vetëm disa dekada më vonë, ndërkohë që në Shqipëri mbeti e tillë deri në mesin e viteve '40.

---

[14] Francis Fukuyama, *State-Building: Governance and World Order in the 21st Century*. Ithaca and London: Cornell University Press, 2004.

[15] Convention between Great Britain, France, and Russia, on the One Part, and Bavaria on the Other, Relative to the Sovereignty of Greece. American Journal of International Law. 1918;12(S2):68-74, Cambridge University Press, 2017.

[16] Thanos Veremis, *The modern Balkans: a concise guide to nationalism, politics, the rise and decline of the nation state.* LSEE Research on South Eastern Europe, London, UK, 2015, 22.

Në Bullgari gjithashtu Kushtetuta e vitit 1979 ishte hartuar në modelin belg të vitit 1831[17], ku disa norma demokratike dhe sidomos elementë të veçuar si ndalimi i skllavërisë dhe trafikimit të qenieve njerëzore u bënë motive ta konsideronin atë një kushtetutë liberale dhe të avancuar për kohën[18], e bazuar në ndarjen dhe balancën e pushteteve, konceptet e zgjedhjes, llogaridhënies dhe përgjegjësive institucionale. Në Shqipëri Kushtetuta e vitit 1914 ishte në të njëjtën linjë, por moszbatimi i saj praktik nuk lejon matjen e impaktit dhe vlerësimin e ndikimit.

Korrelacionet midis Konferencës së Londrës (1912-1913) dhe Shqipërisë e Kosovës, ndonëse me ndikime të mëdha në rrjedhat e shtetformimit dhe ecurisë përgjatë shekullit të fundit, nuk janë unike. Referimi tregon se modele të përafërta gjenden edhe në historinë bashkëkohore të disa shteteve, përfshirë fqinj e shtete rajonale si Greqia (Protokolli i Londrës 1830) dhe Bullgaria (Kongresi i Berlinit 1878). Praktika sipas të cilës një konferencë e Fuqive të Mëdha të kohës diskuton, konfirmon dhe vendos krijimin e një shteti, përcakton konturet e veprimit të tij dhe pozitën ndërkombëtare, kufijtë dhe elementët e tjerë identifikues, ka histori të gjatë dhe komplekse, madje edhe bashkëkohore në të gjithë historinë e shteteve përbërëse të rajonit tonë. Nga mesi i shekullit XIX dhe në fillimet e shekullit XXI kanë ndryshuar lista e "Fuqive të Mëdha" dhe forma e ndikimit të tyre në sistemet qeverisëse në Evropën Juglindore, por koncepti i "Fuqive të Mëdha" dhe ai i ndërhyrjes pozitive prej tyre kanë mbetur të njëjta.

Imponimi nga jashtë i zgjidhjeve për shtetet, përfshirë imponimi i territoreve, udhëheqjes vendore, fronit mbretëror apo kornizës kushtetuese, simboleve apo raporteve me shtetet fqinje, mbetën një prej tipareve të përhershme të vendimmarrjeve nga Fuqitë e kohës. Shtetet e reja dhe të vogla nuk posedojnë fuqi imponuese politike dhe as ushtarake, ekonomike dhe as njerëzore, të atilla që të mund të kushtëzojnë vendimmarrjen e Fuqive të kohës, megjithatë ato zotërojnë fuqi të kufizuara dhe aftësi reagimi të mjaftueshme që të mund të ndikojnë në ecurinë e negociatave dhe të krijojnë ura lidhëse

---

[17] Evgeni Tanchev, Martin Belov, Cristian Ionescu et al., *Constitutional Law of 2 EU Member States*: Bulgaria and Romania, I-8. Alphen aan den Rijn: Kluwer, 2008.

[18] Raymond Detrez, *"Tûrnovo Constitution". Historical Dictionary of Bulgaria (2nd ed.). Lanham, Maryland;* Toronto; Oxford: The Scarecrow Press, Inc, 2006, 448-449.

midis diplomacisë negociuese, gjendjes faktike dhe tendencave në terren. Rastet e Bosnjës dhe Kosovës janë raste tipike të ndikimit të realpolitikës në vendimmarrjen finale të fuqive politike botërore, ashtu siç edhe rastet e Greqisë në vitet ‘30 të shekullit XIX dhe të Bullgarisë në fillimet e shekullit XX ishin gjithashtu tregues i balancës midis realpolitikës dhe interesave gjeopolitike. Praktika të tilla dëshmojnë se krijimi dhe mbijetesa e shteteve të reja ndërvaret kryesisht nga legjitimiteti i brendshëm dhe qasja e jashtme. Nëse presioni dhe oferta nga brenda drejt zgjidhjes janë të pamjaftueshme, zgjidhjet nga jashtë mbeten të kufizuara dhe të motivuara më shumë nga nevojat gjeopolitike afatshkurtra sesa nga vizioni afatgjatë në favor të shteteve të qëndrueshme. Modelet bashkëkohore në vendet postkonflikt (Bosnjë dhe Kosovë, Timori Lindor dhe Irak apo Afganistan) gjejnë tipare të ngjashme në modelet e aplikuara në periudhën e shpërbërjes graduale të perandorive dhe ngritjes së shteteve kombëtare në shekullin XIX dhe XX në Europën Juglindore.

Në këtë kontekst, analiza mbi Konferencën e Londrës dhe ndikimet e saj në hartën politike shqiptare dhe rajonale, kërkon qasje shumë më komplekse dhe gjithëpërfshirëse sesa në raportet dypalëshe apo leximi nga këndvështrimi i interesit specifik të një vendi. Ekzistenca e shtetit të Kosovës sot, ndryshe nga vendimmarrja e Londrës më 1912-1913 nuk e përjashton njëra-tjetrën, por e plotëson logjikën analizuese dhe argumentin se vendimmarrjet janë pjesë të proceseve politike, jo akte fundore dhe shteruese politike. Ky është rasti tipik kur analiza krahasuese historike mund të ofrojë qasje më të gjerë dhe më profesionale të trajtimit të ngjarjeve historike, si dhe mund të ndihmojë për të shpjeguar më qartë ngjarjet e pasojat e tyre, pavarësisht konotacionit apo vendit të përkohshëm që kanë marrë në memorien subjektive kombëtare.